**Data17/02/2023**

**PROCESVERBAL ______**
**Tipi i kontratës-PUNË**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN**
**E**
**SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

**OBJEKTI I PROKURIMIT**: **"Sistemim Asfaltim i Rruges Fushe-Bulqize Loti II"**

Kodi Perkates ne Fjalorin e Perbashket te Prokurimit(**CPV**):**, Pune ndertimi 45000000-7**

**Vlera e Fondit Limit**: 16 370 790(Gjashtembedhjetemilion e treqindeshtatedhjetemije e shtateqindenentedhjete*)*leke pa TVSH

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”,autoriteti/enti kontraktor **Bashkia Bulqize** ka hartuarprocesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kritereve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

## KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës8,*

*b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

Shuma e kërkuar e sigurimit të ofertës është **: 327 415,8(** Treqind e njezeteshtatemije e katerqindepesembedhjete presje tete)leke .

Autoriteti/entikontraktor pranon vlerën e pagesës së sigurimit të ofertës nga ofertuesi, në vlerë monetare në llogarinë e autoritetit/ entit kontraktor RaiffeisenBank 8704030890 kodi institucionit: 2103001

Autoriteti/entikontraktor pranon pagesën e vlerës së sigurimit të ofertës nga ofertuesi edhe në formën:
i. garancisë bankare **x**
ose
ii. ngashoqëri sigurimi të licencuara nga autoritetet kompetente **x**

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, dhe nenin 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik**".**

*c. Formulari i ofertes sipas Shtojce 1*

Në zbatim të Ligjit nr.162/2020 "Për prokurimin publik" dhe te VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", cdo operator ekonomik pjesemarres duhet te ketë pjesë të ofertës së tij edhe formularin e ofertës sipas Shtojcës 1 të Dokumenteve Standarte të Tenderit.

**2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:**

**2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale.**

.Sipas kritereve te pergjithshme te kualifikimit

**Argumentimi**: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenin39, pika 6/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik"si dhe nenit

______________________________________________________________________

(Shënim: *përcaktoni **nëse është rasti**, aktin konkret ligjor ose nënligjor që parashikon plotësimin e ndonjë kërkese specifike për ushtrimin e veprimtarisë profesionale që lidhet me objektin e prokurimit*aponevojënqë*operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë, kur një gjë e tillë është e detyrueshme nga legjislacioni përkatës).*

**2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

Kopje të deklaratave të xhiros mesatare vjetore, të realizuar nga Operatori Ekonomik ofertues gjatë 3 *(tre)* viteve të fundit **(2019, 2020, 2021)**, lëshuar nga Administrata Tatimore, ku vlera e xhiros per te pakten nje nga vite e periudhes se kerkuar duhet te jete jo me e vogel se vlera e fondit limit të kontratës që prokurohet.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Duke qene lloji i procedure "e hapur e thjeshtuar", percaktimi i vleres se kerkuar eshte bere ne mbeshtetje te nenin 43, pika 2, germa "c" të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" ku percaktohet se: "vlerën e parashikuartëkontratës, nëprocedurat e prokurimitnenkufirineulëtmonetar".

---

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërëbazuar eshte bere ne mbeshtetje te nenin 43, pika 1 " të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" ku percaktohet se: "Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare".

Vendosja e ketij kriteri kualifikues i sherben Autoritetit Kontraktor per te vertetuar se operatori ekonomik fitues i zoteron te gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare per te permbushur me sukses kontraten. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar se ky kriter kualifikues i sherben Autoritetit Kontraktor per te vertetuar se operatori ekonomik fitues i zoteron te gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare per te permbushur me sukses kontraten.

2.2.2. Kopje të çertifikuara të bilanceve të 3 *(tre)* viteve të fundit **(2019, 2020, 2021)**,të paraqitura në Administratën Tatimore dhe të konfirmuara prej tyre, ku të paktën në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivit dhe pasivit. Nëse operatori ekonomik ofertues eshte ne kushtet e parashikuara nga neni 41, pika ”c”, e ligjit nr.10091 date 5.3.2009 *”Per auditimin ligjor, organizimin e profesionit te ekspertit kontabel te regjistruar dhe tekontabilistit te miratuar”* i ndryshuar, atëherë secili bilanc duhet te shoqerohet me akt-ekspertizen e kryer nga eksperti kontabel.

**Argumentimi:**Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr.10091 date 5.3.2009 *”Per auditimin ligjor, organizimin e profesionit te ekspertit kontabel te regjistruar dhe te kontabilistit te miratuar”* i ndryshuar.

Operatori ekonomik duhet të paraqese një vërtetim që ka paguar **taksat dhe tarifat vendore për vitin 2021-2022** për çdo vend të ushtrimit të aktivitetit (sipas QKB), sipas afateve të kryerjes së pagesave të përcaktuara nga çdo njësi e qeverisjes vendore.

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë vërtetim për taksat dhe tarifat vendore leshuar nga Bashkia ne te cilen eshte regjistruar ne QKR

Nje vertetim qe konfirmon shlyerjen e te gjitha detyrimeve te matyruara te energjise elektrike te kontratave te energjise qe ka operatori ekonomik qe eshte regjistruar ne Shqiperi :mosshlyerja e e detyrimeve te energjise elektrike ,perben shka per skualifikimin e operatorit ekonomik ,pervec rastit kur rezulton se detyrimet e papaguara te energjise elektrike ,te konfirmuar ne vertetimin e leshuar nga furnizuesi ,jane ne process ankimi ne gjykate :furnizuesi i energjise elektrike,eshte i detyruar qe te leshoje kete deshmi jo me vone se 5 dite nga depozitimi i kerkeses nga operatori.

**Ky kriter permbushet nepermjet paraqitjes se Formularit Permbledhes te Vetdeklarimit.**

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" dhe ne ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 "PërSistemin e TaksaveVendore" indryshuar, ne ligjin nr.9920 date 19.05.2008

“Per procedurattatimore” indryshuar, neni 3.1/a, b, c dheneni 40, ne ligjin nr.131/2015 “Per QKB” indryshuar, sidhe ne ligjin nr.9723 date 03.05.2007 “Per QKR” indryshuar.

**2.3 Kapaciteti teknik:**

**a-**Punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogel se 50 % e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

**b)** Punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më te vogel se dyfishi I vlerës limit të kontratës që prokurohet.

**-Për të vërtetuar përvojen e mëparshme duhet të paraqiten:**

**-Nëse kontrata është realizuar me institucione shtetërore:**

Formulari I vlerësimit (sipas shtojcës 9 I shoqëruar me:

-Kontratë punimesh;

-Situacion përfundimtar;

-Akt-kolaudimi;

-Procesverbal për marrje në dorëzim të punimeve të kryera.

Për kontratat e realizuara si Bashkim Operatorësh, operatori ekonomik ofertues duhet te paraqesë: Kontraten e bashkimit të operatorëve ekonomikë si dhe preventivin e ndarjes së punimeve të marra përsipër nga secili operator ekonomik të deklaruara në fazën e tenderimit.

Për kontratat e realizuara si Nënkontraktor, operatori ekonomik ofertues duhet te paraqesë: Kontratën bazë ndërmjet Kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktor; si dhe Miratimi zyrtar si nënkontraktor i deklaruar nga ana e autoritetit kontraktor.

**-Nëse kontrata është realizuar me subjekte private:**

Formulari i vlerësimit i shoqëruar me:

- Kontratë punimesh,

-Situacionin përfundimtar,

-Akt-kolaudimin,

-Çertifikatën e marrjes ne dorezim,

Për kontratat e realizuara si Nënkontraktor, operatori ekonomik ofertues duhet te paraqesë: Kontratën bazë ndërmjet Kontraktorit dhe Investitorit.

**Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura për përvojen e suksesshme e bën ofertën të kualifikueshme.**

***Argumentimi:*** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenit 55, pika 4, germa"a" të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik". Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanëpërvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që punët e mëparshme të ngjashme të jenë minimalisht në vlerat 50 % të vlerës së fondit limit,për një objekt të vetëm, osesa vlera e fondit limit, për punët totale të ngjashme të kryera në 5 vitet e fundit, që janë brenda vlerave kufi të përcaktuara në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

---

**a.** Duke qene se kjo procedure prokurimi do te konkludoje me nje kontrate pune per te deshmuar pervojen e meparshme vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë sa 50% të vlerës së përllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë 5 viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës ose punë të ngjashme deri ne nje kufi ku vlera monetare totale e punëve të kryera e marrë së bashku gjatë pese viteve të fundit është jo më e vogel se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet **.**

---

**Liçensa profesionale ,lidhur me ekzekutimin e puneve te kontrates,per kategorite e meposhtme:**

Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë bazuar nëformatin e miratuar me Vendim tëKeshillit tëMinistrave Nr. 42 datë 16.01.2008 "Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi", e cila përfshin kategoritë e mëposhtme:

**Punime të Përgjithshme Ndërtimi**

- NP.1 A, Punime gërmimi në tokë.
- NP.4 A, Rruge, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvai, metro, pista aeroportuale

- N.S-6 A, Sinjalistike rrugore jo ndricuese
- N.S 18 A, Punime topogjeodezike

Në rastet e mbështetjes në kapacitete të subjekteve të tjera / Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë, secilianëtar i bashkimitduhet t'i disponojënë raport me zërat, përqindjen e marrë përsipër, sipas angazhimit me shkrim / kontratën e bashkëpunimit.

*Për Operatorët e huaj të bëhet njehsimi i liçencës profesionale që disponojnë nga vendi i origjinës pranë Institucionit përkatës, në plotësim të licencave profesionale të kërkuara për ekzekutimin e kontratës.*

- **Licence III.2.B Per Grumbullimin dhe Transportimin e mbetjeve nga prishjet dhe ndertimet.**

**a) Çertifikatat që duhet të paraqesin Operatoret Ekonomike:**

Certifikate ISO 9001 - 2015 "Per Sistemin e menaxhimit te cilesise", e vlefshme ose ekuivalente ne rast te bashkimit te operatoreve cdo operator duhet te paraqese ISO.

Certifikate ISO 14001-2015 "Per sistemin e menaxhimit te mjedisit", e vlefshme ose ekuivalente ne rast te bashkimit te operatoreve cdo operator duhet te paraqese ISO.

Certifikate ISO 45001-2018"Per sistemin e menaxhimit te shendetit dhe sigurimit ne pune", e vlefshme ose ekuivalente ne rast te bashkimit te operatoreve cdo operator duhet te paraqese ISO.

- Certifikate ISO 39001:2012"Per sistemin e menaxhimit te trafikut rrugor e vlefshme ose ekuivalente ne rast te bashkimit te operatoreve cdo operator duhet te paraqese ISO.

- Certifikate ISO 3834-2:2006 "Per sistemin e menaxhimit e cilesise se saldimit e vlefshme ose ekuivalente ne rast te bashkimit te operatoreve cdo operator duhet te paraqese ISO.

- Nese certifikatat jane ne gjuhe te huaj, ato te paraqiten te perkthyera dhe te noterizuara ne gjuhen zyrtare shqipe. Keto certifikata te jene leshuar nga nje organ i vleresimit te konformitetit i akredituar nga Drejtoria e Pergjithshme e Akreditimit ose nga organizmat nderkombetare akreditues te njohur nga Republika e Shqiperise.

- Certifikatat duhet te jene te vlefshme ne kohen e zhvillimit te tenderit.

- Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili operator ekonomik duhet te dorezoje certifikatat e mesiperme sipas natyres se punimeve qe do te marre persiper te realizoje, referuar kontrates se bashkepunimit te nenshkruar.

.

***Argumentimi:*** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", nenin39, pika 6/a, të VKMnr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik".

Kategoritë e kërkuara te ISO-ve jane pershtatur me zerate punimeve te objektit te prokurimit.

3.4 **Operatorëtekonomikepjesëmarrësduhettekenëdrejtuestekniktëpunësuartëvërtetuar me kontratëpune me koheteploteteperfshire ne listpagesa .**

**-**Operatori Ekonomik duhet të ketë punësuar minimalisht te pakten **40 punonjes** (perfshire dhe stafin teknik)për periudhen e 3 (tre) muajve te fundit **NENDOR 2022-JANAR 2023** dhe te figurojne ne listepagesat e shoqerise per te pakten muajin e fundit ngadata e publikimit te njoftimit te kontrates,ku ndarja e tyre vijon si me poshte:

- Vërtetim të lëshuar nga administrata tatimore sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi, ku te specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj për periudhën e mesiperme.

- Listë pagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi, te paraqitura dhe te konfirmuara nepermjet formes elektronike nga organet tatimore për periudhën e mesiperme.

**b)** Operatori Ekonomik duhet te kete të punësuar për kryerjen e të gjitha punimeve në këtë objekt, **Drejtuesit Teknik** si me poshte:

- Inxhinier Topograf/Gjeodet 1(nje)
- Inxhinier Ndertimi (profile infrastrukture) 1(nje)
- Inxhinier Mjedisi 1(nje)

**Argumentimi**:**Inxhinieri topograf** duhet te figuroje gjate gjithe kohes ne objekt ne menyre qe te kete koherence te vazhdueshme per realizimin e germimeve dhe mbushjeve ne rruge si dhe per piketimin e shtresave rrugore dhe per cdo lloj punimi tjeter sipas preventivit qe ka nevoje per kuota topografike.
**Inxhinieri i ndertimit**: i cili preferohet te jete i profilit infrastrukture ,sepse lidhet ngushte me objektin e prokurimit dhe cdo lloj punimi ne preventiv konsiderohet si punim ndertimi dhe kerkon me domosdoshmeri pranine e inxhinierit ne objekt.
**Inxhinier Mjedisi:** duhet te figuroje ne objekt ne menyre qe te kete koherence te vazhdueshme per realizimin e ndertimit dhe ne rehabilitimin e mjedisit ,kthimin ne gjendjen e meparshme pas punimeve qe kryhen ne te gjithe gjatesine e rruges ne territorin e fshatit Fushe -Bulqize.

**Drejtuesit Teknik** te jene te përfshirë në liçencën e shoqërisë, të figurojnë në listëpagesa për të paktën 3 (tre) muajt e fundit, te kene kontrate pune te vlefshme, të deklarojne se nuk jane te angazhuar në kontrata të tjera dhe se do të jenë te pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt.

Operatori Ekonomik permbushjen e ketij kriteri duhet ta përcaktojë me anë të një deklarate nga administratori i shoqerise per personelin kryesor, Drejtuesit Teknik të punimeve në objekt.

Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë vërtetësinë e deklaratës. Në rast deklarimi te rreme do të veprohet në përputhje me parashikimet e Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”.

**Ndersa Operatori Ekonomik fitues, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve te ankimit, sipas përcaktimeve të bëra në pikën 6, të nenit 26, të VKM Nr.285 datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" të ndryshuar, per Drejtuesit Teknik duhet te dorezoje dokumentacionin:**

**<u>Drejtuesit Teknik</u>** te jene te përfshirë në liçencën e shoqërisë, të figurojnë në listëpagesa për për periudhën e mesiperme **NENDOR 2022-JANAR 2023**. te kene kontrate pune te vlefshme, të deklarojne se nuk jane te angazhuar në kontrata të tjera dhe se do të jenë te pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt shoqeruar me dokumentacionin e meposhtem:

- Kontratë pune e vlefshme gjate gjithe kohes se zbatimit te punimeve objekt kontrate;
- Diplomë profesionale;
- CV
- Libreze pune

Operatori Ekonomik permbushjen e ketij kriteri duhet ta përcaktojë me anë të një deklarate nga administratori i shoqerise per personelin kryesor, Drejtuesit Teknik të punimeve në objekt.

.

**2.3.4Operatori Ekonomik duhet të ketë të punësuar ne stafin e tij personel te kualifikuar dhe te certifikuar sipas profesionit qe kryejne dhe te pasqyruar ne liste pagesat e shoqërisë për per te pakten muajin e fundit nga data e publikimit te njoftimit te kontrates, me profesione si me poshte:**

- Operatori ekonomik ofertues duhet te kete te punesuar minimalisht **1(nje)Teknik ndertimi** per kete duhet te paraqes :
  Kontrate individuale pune te vlefshme .
  Diplome ose deshmi Aftesie Profesionale(te vlefshme).
  Deshmi e aftesise per sigurimin teknik (te vlefshme)leshuar nga institucionet perkatese .
  Si dhe ,te figuroje ne listepagesat e shoqerise per te pakten muajin e fundit nga data e publikimit te njoftimit te kontrates.

<u>Argumentimi</u>:**Tekniku i ndertimit** eshte i nevojshem per orjentimin dhe sigurimin e cilesise ne pune vazhdimisht nga grupi i punes ne perputhje me preventivin e objektit.

- Operatori ekonomik ofertues duhet te kete te punesuar minimalisht **3(tre)Manovratore** per kete duhet te paraqes:
  Kontrate individuale pune te vlefshme .
  Deshmi Aftesie Profesionale(te vlefshme).
  Deshmi e aftesise per sigurimin teknik (te vlefshme)leshuar nga institucionet perkatese .

Si dhe ,te figuroje ne listepagesat e shoqerise per te pakten muajin e fundit nga data e publikimit te njoftimit te kontrates.

<u>**Argumentimi**</u>:**Manovratoret** duhet te sherbejne per perdorimin e makinerive te tonazhit te rende ku konkretisht kemi :nje monovrator per eskavator ,nje per rrulin nje per fadromen ,nje Grajderi ndersa gjate hedhjes se asfaltit nuk eshte e nevojshme prania e eskavatorit dhe fadromes ,prandaj monovratoret do te sherbejne per makinerite asfaltshruese.

- Operatori ekonomik ofertues duhet te kete te punesuar minimalisht **4(kater*)Shofer*** per kete duhet te paraqes :

  Kontrate individuale pune te vlefshme .
  Deshmi Aftesie Profesionale(te vlefshme).
  Deshmi e aftesise per sigurimin teknik (te vlefshme)leshuar nga institucionet perkatese .
  Si dhe ,te figuroje ne listepagesat e shoqerise per te pakten muajin e fundit nga data e publikimit te njoftimit te kontrates.

<u>**Argumentimi**</u>:Referuar perllogaritjes se puntorise dhe makinerive duke u bazuar ne analizat teknike te zerave te preventivit eshte e nevojshme qe ne kantjer te kemi prezencen e vazhdueshme te nje autobot uji,dhe Autovincit per shkarkimiin e tubave te celikut dhe tombinave te betonit dhe 4 (Kater)kamiona vetshkarkues per realizimin e punimeve te transportit dhe shtresave ne rruge.

- Operatori ekonomik ofertues duhet te kete te punesuar minimalisht **1(nje)Karpentier** per kete duhet te paraqes:

  Kontrate individuale pune te vlefshme .
  Deshmi Aftesie Profesionale(te vlefshme).
  Deshmi e aftesise per sigurimin teknik (te vlefshme)leshuar nga institucionet perkatese .
  Si dhe ,te figuroje ne listepagesat e shoqerise per te pakten muajin e fundit nga data e publikimit te njoftimit te kontrates.

<u>**Argumentimi**</u>:Karpentiere eshte i nevojshem per realizimin e cdo punimi te preventivit qe lidhet me armaturat e betonit sic kemi beton per puseta,mure,portale etj.

- Operatori ekonomik ofertues duhet te kete te punesuar minimalisht **1(nje)Betonues** per kete duhet te paraqes :

  Kontrate individuale pune te vlefshme .
  Deshmi Aftesie Profesionale(te vlefshme).
  Deshmi e aftesise per sigurimin teknik (te vlefshme)leshuar nga institucionet perkatese .
  Si dhe ,te figuroje ne listepagesat e shoqerise per te pakten muajin e fundit nga data e publikimit te njoftimit te kontrates.

<u>**Argumentimi**</u>:Betonuesi eshte i nevojshem per realizimin e cdo punimi te preventivit qe lidhet me derdhjen e betonit sic kemi beton per puseta,mure,portale etj.

- Operatori ekonomik ofertues duhet te kete te punesuar minimalisht**1(nje)Murator** per kete duhet te paraqes:

  Kontrate individuale pune te vlefshme .
  Deshmi Aftesie Profesionale(te vlefshme).
  Deshmi e aftesise per sigurimin teknik (te vlefshme)leshuar nga institucionet perkatese .
  Si dhe ,te figuroje ne listepagesat e shoqerise per te pakten muajin e fundit.nga data e publikimit te njoftimit te kontrates.

  **Argumentimi**:Muratorieshte i nevojshem per realizimin e cdo punimi te preventivit qe lidhet me ndertimin e mureve prej betoni ose bruto betoni etj

- Operatori ekonomik ofertues duhet te kete te punesuar minimalisht**1(nje)Bojaxhi per vizime te rruges** per kete duhet te paraqes:

  Kontrate individuale pune te vlefshme .
  Deshmi Aftesie Profesionale(te vlefshme).
  Deshmi e aftesise per sigurimin teknik (te vlefshme)leshuar nga institucionet perkatese .
  Si dhe ,te figuroje ne listepagesat e shoqerise per te pakten muajin e fundit.nga data e publikimit te njoftimit te kontrates.

**Argumentimi**:Bojaxhiu eshte i nevojshem per realizimin e cdo punimi te preventivit qe lidhet me vizimet ne rruge

- Operatori ekonomik ofertues duhet te kete te punesuar minimalisht **1(nje)Saldator** per kete duhet te paraqes:

  Kontrate individuale pune te vlefshme .
  Deshmi Aftesie Profesionale(te vlefshme).
  Deshmi e aftesise per sigurimin teknik (te vlefshme)leshuar nga institucionet perkatese .
  Si dhe ,te figuroje ne listepagesat e shoqerise per te pakten muajin e fundit.nga data e publikimit te njoftimit te kontrates.

**Argumentimi**:Saldatori eshte i nevojshem per realizimin e cdo punimi te preventivit qe lidhet me saldimin e tubave te celikut gjate realizimit te punimeve ne veprat e artit.

- Operatori ekonomik ofertues duhet te kete te punesuar minimalisht **25(njezetepese)punetore ndertimi pa perfshire stafin teknik** per kete duhet te paraqes Kontrate individuale pune te vlefshme ,si dhe ,te figuroje ne listepagesat e shoqerise per te pakten muajin e fundit.nga data e publikimit te njoftimit te kontrates.Punetoret e ndertimit duhet te jene me profesion sipas **VKM NR 514 date 20.09.2017,te specializuar per punime ne rruge ,punime prishje ,punime betoni etj.**

**Ndersa Operatori Ekonomik fitues, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve te ankimit, sipas përcaktimeve të bëra në pikën 6, të nenit 26, të VKM Nr.285 datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" të ndryshuar, duhet te dorezoje dokumentacionin:**

- Deshmi e aftësisë profesionale për përdoruesit e makinerive të rënda të ndërtimit dhe punimeve në tokë (të vlefshme) leshuar nga Drejtoria e Pergjithshme e Sherbimit te Transportit Rrugor;
- Kontrate pune / sherbimi te vlefshme;
- Kartele personale e sigurimit teknik të vlefshme te lëshuara te lëshuara nga institucione shteterore ose nga subjekte juridike private të akredituara për çertifikimin e punonjësve.

**2.3.5** Operatori Ekonomik duhet të paraqesë makineri dhe pajisje sipas tabeles se meposhtme, të cilat duhet të jenë në pronësi të tij ose me qera të vërtetuara këto me dokumentacionin përkatës:

| Nr | LLOJI I MAKINERIVE | PRONESIA | SASIA Minimumi |
|---|---|---|---|
| | Kamionvetshkarkues me kapacitet mbajtes mbi 8 ton | Ne pronesi ose me qera | 1 cope |
| • | Kamionvet shkarkues me kapacitet mbajtes mbi 6 ton | Ne pronesi ose me qera | 1 cope |
| • | Autovinç | Ne pronesi ose me qera | 1 cope |
| • | Eskavator me goma | Ne pronesi ose me qera | 1 cope |
| • | Eskavator me zinxhir | Ne pronesi ose me qera | 1 cope |
| • | Vibrator Betoni | Ne pronesi ose me qera | 1 cope |
| • | Kamioncine me kapacitet mbajtes 3.5 - 5 ton | Ne pronesi ose me qera | 1 Cope |
| • | Betoniere 0.5 m3 | Ne pronesi ose me qera | 1 cope |
| • | Autobot uji | Ne pronesi ose me qera | 1 cope |
| • | Autobitumatrice | Ne pronesi ose me qera | 1 cope |
| • | Rrul me kompresor | Ne pronesi ose me qera | 1 cope |
| • | Asfaltroshtruese | Ne pronesi ose me qera | 1cope |
| • | Linje Inerte | Ne pronesi ose me qera | 1cope |
| • | LINJE ASFALTOBETONI | Ne pronesi ose me qera | 1cope |

| | | | |
|---|---|---|---|
| • | Rrul | Ne pronesi ose me qera | 1cope |
| • | Grejder | Ne pronesi ose me qera | 1cope |
| • | Armature derrase | Ne pronesi ose me qera | 150 m2 |

a) *Operatori ekonomik* ***duhet te kete ne dispozicion apo mund ti vihen ne dispozicion paisjet teknike (pronesi ose me qera),te nevojshme per ekzekutimin e kontrates si me poshte :***

***-kokore ,minimumi 20 cope***

***-fikese zjarri te levizshme me kapacitet 5 litra secila ,minimumi 2cope.***

***-Prozhektor ndricimi naten minimumi 2 cope.***

-***Komplet i ndihmes se shpejte ,minimumi 2 cope***

-***Tabela paralajmeruese per sigurine ne objekt minimumi 4 cope.***

b) *Per mjetet me goma qe shenohen ne regjistra publike duhet te paraqitet* ***dokumenti qe verteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), plus çertifikaten e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjeti(te vlefshme),taksat vjetore dhe certifikata e pronesise se mjetit.***

c) *Per mjetet e siguruara me qera,****dokumenti qe verteton regjistrimin e tij (leja e qarkullimit)plus çertifikaten e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjeti(te vlefshme),taksat vjetore dhe certifikata e pronesise se mjetit.si dhe duhet te shoqerohen me kontraten perkatese noteriale te qerase ,evlefshme per te gjithe periudhen e realizimit te kontrates objekt i ketij prokurimi****.*

d) *Ne rastin e mjeteve apo paisjeve te tjera* ***duhet te jene aktet e zhdoganimit ose faturat tatimore te blerjes.***

e) *Per automjetet qe nuk shenohen ne rregjistra publik ,****duhet te paraqitet dokumenti qe verteton pronesine e tyre,apo marrjen me qera te tij/tyre.***

f) *Operatori ekonomik* ***duhet te paraqese foto per secilin mjet te deklaruar ku te jete e dukshme dhe targa e mjetit.***

g) *Makinat e transportit* ***te shoqerohen gjithashtu edhe me Leje te Transportit te Mallrave(te vlefshme),leshuar nga organet kopetente ne emer te shoqerise apo subjektit pronar te mjetit ,ne perputhje me legjislacionin ne fuqi.***

h) *Autoriteti Kontraktor rezervon te drejten te verifikoje dhe kontrolloje ne çdo kohe deri ne perfundimin e kontrates mjetet e pajisjet teknik*

i) *Makinerite e mesiperme* ***nuk duhet te jene te angazhuara ne kontrata te tjera,(Deklarate nga Administratori I Shoqerise Ofertuese).***

j) *Per linjen e inerteve ne rast se Operatori Ekonomik i disponon ne pronesi duhet te paraqese aktin e pronesise perkatesisht, ne rast se operatori ekonomik nuk i disponon ne pronesi , duhet te paraqese kontrate qeraje apo kontrate furnizimi. Referuar specifikimeve teknike te realizimit te objektit,*

k) *Linja per prodhim asfaltobetoni duhet te kete nje largesi jo meshume 40km nga vend i punimeve te ketij objekti qe te mundesohet permbushja e standarteve te percaktuara ne VKM Nr 628 date 15.07.2015 "Per miratimin e Rregullave Teknike te Projektimit dhe Ndertimit te Rrugeve"te ndryshuar, që te mund të garantojnë furnizimin e materialeve brenda kushteve teknike.*

***Argumentimi:**Vendosja e 40 km ka ardhur si pasoje e mos realizimit te cilesise te punimeveve te ngjashme.Vendosja e ketij kriteri bazohet ne VKM NR 628 date 15.07.2015,ku prodhimi asfaltobetonit ,transporti, perzjerja dhe ngjeshja duhet te kryhet ne nje kohe te shkurter jo me shume se 2 ore **.***

----Cdo ofertues duhet te paraqese grafikun e punimeve te firmosur dhe vulosur nga administratori. Ne rast BO grafikun e punimeve duhet te jete i firmosur dhe vulosur nga secili prej administratoreve perkates..

**Argumentimi:** Kërkesa e mesiperme eshte vendosur sipas pikës 4, të Nenit të 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik" si dhe Kreut V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, germa "d" të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021"Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", **"6. Për të provuarpërshtatshmërinëpërtëkryerveprimtarinëprofesionale, kapacitetetteknikedheprofesionale, autoriteti/entikontraktorkërkon:… d) mjetet e pajisjetteknike, tënevojshëmpërekzekutimin e objektittëprokurimit, që ka nëdispozicion apo qëmundt'ivihennëdispozicionoperatoritekonomikpërtëpërmbushurkontratën".** Nepermjet ketyre kerkesave, Operatorët ekonomikë duhet të dëshmojnë që kanë mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që kane në dispozicion apo që mund t'u vihen në dispozicion me qellim permbushjen me sukses te kontratës objekt prokurimi.Çdo mjet i kërkuar përkon me proceset ndërtimore sipas zërave përkatës të Preventivit. Dokumentacionishoqëruesikërkuarpërmakineritë, provoncertifikiminligjordheteknikt ëmjetevetëdisponuaranëpërmjetKontratëssëShtitjes apo KontratëssëQirasë. Ky dokumentacionijepgaranciAutoritetitKontraktor se punimet do tërealizohen me cilësi, siguridhenërespektimtëGrafikuttëPunimeve (icili do tëpublikohetsëbashku me Dokumentat e Tenderit).

**Përsaipërketvlerëstëfondit limit përllogaritjaështëbërësipasPreventivit të projektit teknik të realizuar nga firma fituese, sidhebazuarnëvendimin Nr. 629, datë 15.7.2015 "Përmiratimin e manualeveteknike tëçmimevetëpunimevetëndërtimitdhetëanalizaveteknike tëtyre"**

**Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.**

**Njesia e Prokurimit**